Многу јавни претпријатија извршуваат работи од витално значење за граѓаните, поради што морат да ги јакнат капацитетите за превенција и намалување на последиците при катастрофи.

Јавниот сектор мора да соработува и со приватниот сектор, да вложуваат во отпорноста од катастрофи. Компаниите треба да се мотивираат да инвестираат во јакнење на отпорноста преку имплементација на стандарди посебно при изградба на детски установи, училишта, спортски објекти, болници, станбени згради и други инфраструктурни објекти.

Јавно приватно партнерство е со огромни предности, но мора да се дефинираат и обврските за намалување на ризиците од катастрофи.

Инвестициите се од суштинско значење и за зајакнување на економската, социјалната, здравствената и културолошката отпорност на граѓаните и општеството во целина. Инвестициите се двигатели на иновациите и развојот и преку почитување на високи стандарди во јакнење на отпорноста се спасуваат животи, се намалуваат материјалните штети во урбаните и руралните средини и финансиските последици од катастрофите.

6.16 Отпорност на граѓаните

Целокупниот систем за кризи и сите реформи мораат да бидат фокусирани на информирање на граѓаните за последиците од катастрофи, нивно активирање за зголемување на стандардите за отпорност од катастрофи, нивно запознавање и едукација како да постапуваат пред и за време на катастрофа или сублимирано зајакнување на отпорноста на граѓаните при катастрофи.

Обврските на граѓаните се дефинирани со закони, но приоритет мора да се даде на нивното оспособување за дејствување пред и за време на катастрофи.

Во градењето на стратегиите и мерките, приоритет мора да се даде на ранливите категории на лица (лица со посебни потреби, болни, стари лица, деца итн.)

7. Меѓународна соработка

Република Северна Македонија и натаму мора да ја продлабочува соработката со соседните држави, на регионално и пошироко ниво. Како дел од НАТО и кандидат за членство во Европската Унија, Република Северна Македонија неопходно е да ги имплементира највисоките стандарди за јакнење на отпорноста од катастрофи, да бара, но и да нуди помош при катастрофи, да го следи технолошкиот развој, технички да ги модернизира субјектите на системот за кризи и да партиципира на меѓународните и регионалните собири.

8. Реформи во системот

Во Република Северна Македонија е воспоставен систем за управување со кризи, заштита и спасување, кој врз основа на законската рамка и преку надлежностите утврдени со оваа рамка, ја остварува основната улога во однос на намалувањето на ризиците од катастрофи. Сепак, анализите за природните несреќи и катастрофите кои настанаа во

последните три декади и последиците од нив, покажуваат дека е неопходно зајакнување на капацитетите на овие институции за ефективно справување со можните ризици од природни несреќи и катастрофи, како и од друг вид на кризи предизвикани од други фактори (тероризам итн.).

Согледувањата и проценките се дека има дуализам, ривалитет и некоординираност на главните носители за дејствување во услови на криза. Тоа произлегува пред сè од законските решенија, но и од постоењето на две самостојни и целосно одвоени институции: Центар за управување со кризи и Дирекција за заштита и спасување.

Од круцијална важност е овие две институции да дејствуваат синхронизирано, што не може да се обезбеди со постоечкиот систем за кризи.

Центарот за управување со кризи кој ги собира информациите за кризи (елементарни непогоди и сл.) и гради проценка за тоа кои субјектите треба да се вклучат во превентивно дејствување, санирање на последиците и сл., да има главен штаб, кој треба да даде насоки на главниот штаб на Дирекцијата за заштита и спасување, *de facto* на институција која има ресурси за дејствување. Во праксата, тука се најголемите недоразбирања, префрлање на одговорноста од една на друга институција и сл.

Ваквата несинхронизираност директно се одразува врз дејствувањето и ефикасноста на системот за управување со кризи.

Анализата на системот за управување со кризи, која ја подготви меѓуресорната работна група во август 2018 година, покажа дека се потребни реформи во системот за управување со кризи, заштита и спасување со цел да се креира системско решение кое што ќе одговара на потребите на Република Северна Македонија, но во исто време ќе биде и резултат и на искуства и добра пракса од земјите на Европската Унија и НАТО.

Тие реформи подразбираат и донесување на ново законско решение со кое ќе се обедини целокупниот систем и ќе ги опфати сите аспекти на системот за кризи, заштита и спасување. Во подготовката се препорачува да се вклучат надворешни експерти од областа и стручни лица кои го познаваат системот (од Факултетот за безбедност, Институтот за одбрана, Воената академија и др.) Исто така, треба да се користат и веќе направените анализи и проценки од УНДП, НАТО, ОБСЕ, Воената академија, Европска команда на САД, Европски цивилен механизам, финален извештај од Трајковски-Партнери Менаџмент Консалтинг - Документациска анализа на постоечката законска регулатива и документите поврзани со системот за управување со кризи од 2008 година.

8.1 Интеграција

Неопходно е да се подготви законско решение кое ќе генерира единствено државно тело со кое ќе се воспостави единствен систем за управување со кризи, заштита и спасување и интегрирање на расположливите капацитети и ресурси на сите административни нивоа, како и сеопфатен пристап за поефикасно и поефективно намалување на ризиците од катастрофи.

Со законското решение ќе се отвори и потребата за измени и дополнувања и на други постоечки закони со кои се уредуваат аспекти од системот, се со цел да се допрецизира улогата на различните институции и тела.

8.2 Функционална ефикасност

За целисходна функционалност на системот, неопходно е функционално да се интегрираат и територијалните противпожарни единици и да се пристапи кон нивно соодветно техничко опремување, обука, изнаоѓање на соодветен начин на финансирање и сл.

Потребно е и дефинирање на хиерархиска поставеност и постоење на единствена команда – единствен штаб за координација на целокупните активности.

Притоа потребно е и да се допрецизира во кои ситуации надлежните служби на регионално и локално ниво треба да реагираат (првичен одговор) без да се чека официјално прогласување на криза и во кои ситуации надлежната институција ќе може да иницира сеопфатна координација вклучувајќи опрема и ресурси на Владата на РСМ во периодот додека се чека официјално прогласување на кризна состојба.

8.3 Обука

За подобрување на состојбата околу планирањето и изведувањето на операциите и процената на ризици, се отвора потребата од обука на персоналот за процесот на планирање и донесување на одлуки како и за спроведување на проценка на ризици. Обуките треба да се одвиваат и преку симулациони вежби, фокусирани на „управување“ со последиците од катастрофа или криза, за намалување на последиците од кризи и сл.

Република Северна Македонија треба да отвори и современ интермедијален центар за обука и тренинг според соодветните потреби и меѓународните стандарди.

Во насока на професионализација на кадарот, институциите кои го сочинуваат системот треба да ја проверат стручноста на постоечкиот кадар, и по потреба да спроведат дообука

или промена на кадар, да се унапреди процесот на кариерен развој, оценување и мотивирање на вработените, а при нови вработувања, да се дефинираат стриктни критериуми.

8.4 Опременување

Опременувањето е битен предуслов за ефикасно справување со кризи. Неопходно е да се набавува соодветна и современа специјализирана и софистицирана опрема (како кај земјите членки на Европската Унија), градежно – техничко уредување на постоечките капацитети за чување и складирање на материјално – техничките средства и опрема за заштита и спасување, набавка на специјален хеликоптер за медицинска заштита со целосна медицинска опрема, набавка на современ софтвер за автоматска обработка на податоци за материјално – техничките средства и упредување на поефикасен систем за сервисирање и одржување.

За подобрување на состојбата со информациско – комуникациските средства, се препорачува обновување на застарената и несоодветна опрема за радиосообраќај, со нова опрема, замена на старите и нефункционални системи за известување, тревожење и набљудување со нови современи системи, унапредување на комуникациите во доменот на телефонскиот систем и ставање во функција на E-112.

Во оваа насока, неопходни се имплементација на системот E-112 и нови решенија за предупредување на граѓаните при можна криза, насоки за спречување и сл.

9. Надлежност на националниот координатор за имплементација на Националната платформа за намалување на ризици од несреќии катастрофи на Република Северна Македонија

Националниот координатор за имплементација на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи ја анализира и следи имплементацијата на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи, ја проучува и анализира системската поставеност на системот за кризи, подготвува анализи и информации за дејствувањето и функционалноста на системот за кризи, предлага решенија за обезбедување на поголема ефективност и ефикасност на системот за кризи, во соработка со субјектите на системот подготвува тригодишен акциски план за развивање и јакнење на капацитетите на системот за кризи, имплементација на меѓународните стандарди за јакнење на отпорноста од катастрофи и друг вид на кризи, раководи со Комитетот за координација и имплементација на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи, ја информира Владата на Република

Северна Македонија за состојбите во системот за кризи, учествува во работата на Управувачкиот комитет и сл.

10. Комитет за координација и имплементација на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи

На предлог на националниот координатор за имплементација на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи, Владата на Република Северна Македонија формира Комитет за координација и имплементација на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи, во чиј состав влегуваат: националниот координатор за имплементација на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи, кој раководи со Комитетот и членови предложени од Центарот за управување со кризи, Дирекцијата за заштита и спасување, Министерството за внатрешни работи, Министерството за одбрана, Министерството за здравство, Министерството за заштита на животната средина, Заедницата на единици на локална самоуправа, итн.

Комитетот го утврдува Акцискиот план за намалување на ризици од несреќи и катастрофи, ја разгледува имплементацијата на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи, како и други материјали сврзани со имплементацијата на Националната платформа.

11. Акциски план

Националниот координатор за имплементација на Националната платформа за намалување на ризици од несреќи и катастрофи во соработка со другите субјекти на системот за кризи, подготвува Акциски план за унапредување, развивање и јакнење на системот за кризи.

Акцискиот план е сублимат на сите проекти на субјектите на системот за кризи, со дефинирање на активностите, носителите и роковите за нивна имплементација.

Акцискиот план на секои три години го усвојува Владата на Република Северна Македонија.

*

*

*

12. Заклучни согледувања

Во Република Северна Македонија по постигнување на Преспанскиот договор со кој се разреши триесетгодишниот спор со Република Грција, се одвиваат значајни реформи во повеќе области, меѓу кои и во системот за управување со кризи, заштита и спасување.

Сеопфатната анализа на поставеноста на системот за кризи детектира одредени слабости, посебно од аспект на насочувањето на активностите, ефикасноста, кординираноста, единство во командувањето и слично. Слабостите првенствено се резултат на несоодветната системска и организациска поставеност, кадровската екипираност и материјално – техничката опременост.

Преку Националната платформа се иницираат и поттикнуват сериозни реформи, при што се користат споредбени искуства и научни согледувања, експертска помош од Европската Унија, како и приоритети од Рамката за акција од Сендаи и други меѓународни документи.

Основни приоритети се:

- изградба на ефикасен и функционален систем за превенција и рано предупредување од можни катастрофи и обединување на целокупниот систем и субјектите за справување со кризи.

- дефинирање на заканите од катастрофи, посебно последиците од климатските промени, загадувањето на воздухот, заканите од тероризам, дејствување во услови на мигрантска криза и друго.

- изградба на капацитети за одржлив развој и јакнење на отпорноста од катастрофина државните институции, јавниот и приватниот сектор, но пред сè зголемување на отпорноста на граѓаните на можни катастрофи.

Имплементацијата на Националната платформа е обврска на сите субјекти сè со цел да се намалат ризиците од катастрофи, да се овозможи одржлив и стабилен развој на сите нивоа, и преку системски и конкретни активности да јакне превенцијата, но и активитетот на граѓаните и државата за справување со катастрофи и друг вид на кризи.

Платформата го поттикнува планирањето, лидерството, менаџментот, мониторингот и евалуацијата на сите активности и мерки кои се преземаат за намалување на ризиците од катастрофи, како и изградба на кохерентноста помеѓу субјектите одговорни за намалување на ризиците од катастрофи, одржливиот развој и еколошките аспекти.

Јакнење на отпорноста на општеството од катастрофи е круцијално прашање на кое мора да работат сите субјекти на системот за кризи.



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Platforma Nacionale për Ulje të Rreziqeve nga Katastrofat

Shkup, shtator 2019

Titulli:

PLATFORMA NACIONALE PËR ULJEN E RREZIQEVE NGA KATASTROFAT

Botues: **Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Përgatitën:

Pavle Trajanov, Kordinator nacional për zbatimin e Platformës Nacionale për Uljen e Rreziqeve nga Fatkeqësite dhe Katastrofat

dhe bashkëpunëtorët:

mr. Verica Filipovska

mr. Elena Zarkovska

Lektorë:

Gabriela Paçovska

Përktheu në gjuhën shqipe:

Elham Hajrullahi

Përktheu në gjuhën angleze:

Emilija Jovanova

Zgjidhje ideore grafike- figurative, formësim të kopertinës dhe përshtatje tekstuale:

Pançe Aleksandar

Përmbajtja

1.	Hyrje	58
2.	Bazat e Platformës nacionale	59
2.1	Korniza për aksion nga	59
2.2	Forumi evropian	60
2.3	NATO	61
2.4	BE	61
2.4.1	Vlerësime dhe rekomandime të Komisionit Evropian	62
3.	Qëllime të Platformës nacionale	63
3.1	Parandalimi	63
3.2	Paralajmërimi i hershëm	65
3.3	Përgjigje gjatë kohës së krizave	66
3.4	Sanimi i pasojave nga krizat	67
4.	Rreziqet – pasoja të mundshme nga katastrofat, viktimat në njerëz, shkatërrimeve të pasurive	67
4.1	Ndryshimet klimatike dhe Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike	68
4.2	Ekosisteme	70
4.3	Tërmete	71
4.4	Përmbytje (sistem integral për menaxhimin me ujëra)	72
4.5	Zjarre	73
4.6	Thatësira	74
4.7	Temperatura ekstreme të ajrit....	75
4.8	Prurje të borës	76
4.9	Erëra	76
4.10	Ndotja e ajrit	77
4.11	Fatkeqësi industriale	77
4.12	Rrezatimi jonizues	78
4.13	Mbetje radioaktive	79
4.14	Sulme terroriste	80
4.15	Pasojat nga kriza e emigrantëve.....	80
4.16	Veprimi në kushte të epidemive.....	81
5.	Paralajmërimi gjatë katastrofave të mundshme (konkretizimi i detyrimeve	82
5.1	Sistemi i alarmit dhe përmirësimi i tij	82
5.2	Informimi i institucioneve kompetente.....	83

5.3 Informimi i qytetarëve	84
5.4 Implementimi i sistemit E-112	84
5.5 Ballafaqimi me lajmet e rrejtshme dhe sulmet kibernetike	85
6. Vendosja e sistemit për menaxhim me kriza, mbrojtje dhe shpëtim.....	86
6.1 Detyrimet e subjekteve të sistemit	86
6.2 Menaxhim me krizat	86
6.3 Qendra për menaxhim me krizat.....	87
6.4 Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim	87
6.5 Ministria e mbrojtjes	88
6.6 Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut	89
6.7 Ministria e Punëve të Brendshme	89
6.8 Drejtoria për punë hidrometeorologjike	90
6.9 Instituti për inxhinieri tërmeti dhe seizmologjiinxhinierike.....	90
6.10Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet shëndetësore	92
6.11 Njësitë territoriale zjarrfikëse	93
6.12Njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe rezistenca e qyteteve.....	94
6.12.1 Njësitë e vetëqeverisjes lokale.....	94
6.12.2 Rezistenca e qyteteve	94
6.13Mediat në procesin e uljes së rreziqeve nga katastrofat	95
6.14Sektori qytetar në procesin e uljes së rreziqeve nga katastrofat	95
6.14.1 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut	96
6.15Ndërmarrjet publike dhe kompanitë (sektori privat)	97
6.16Rezistenca e qytetarëve	98
7. Bashkëpunimi ndërkombëtar	98
8. Reformat në sistem	98
8.1 Integrimi	99
8.2 Efikasiteti funksional	100
8.3 Trajnimi	100
8.4 Sigurimi i pajisjeve	100
9. Kompetencat e koordinatorit kombëtar për implementimin e Platformës nacionale për ulje të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe katastrofat të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	101
10. Komiteti i koordinimit dhe implementimit të Platformës nacionale për ulje të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe katastrofat	101
11. Plani veprues.....	102
12. Shqyrtime përfundimtare.....	102

1. Hyrje

Platforma nacionale për Ulje të Rreziqeve nga Katastrofat[†] është dokument i cili në mënyrë sistimore i nxit dhe i obligon subjektet e sistemit për menaxhim me kriza, mbrojtje dhe shpëtim, të veprojnë në mënyrë më të organizuar dhe efektive për paralajmërim të hershëm, parandalim, reduktim dhe sanim të pasojave nga katastrofat e mundshme.

Republika e Maqedonisë së Veriut edhe më tej është e ekspozuar ndaj katastrofave elementare dhe llojeve të tjera, veçanërisht si rezultat i ndryshimeve klimatike, zonës sizmike, shtretërve jo të rregullt të lumenjve, erozionit si pasojë e shkatërrimit të pakontrolluar të fondit pyjor, ekspozimit ndaj zjarreve, trajtimit të papërshtatshëm të mbetjeve, mangësive në ndërtimtari, jorezistencës së objekteve ndaj ndikimeve të jashtme, kërcënimeve nga terrorizmi, fluksit të emigrantëve, sistemeve mbrojtëse të dobëta nga sulme me armë biologjike etj.

Gjithkund në botë, përfshi edhe këtu te ne, gjatë katastrofave, mund të ketë dëmtime të mëdha materiale dhe viktima në njerëz, në rast se kësaj çështjeje nuk i qasemi në mënyrë të organizuar dhe sistimore në pjesën e ndërtimit të sistemit, i cili obligon në vendosjen e standardeve për parandalim dhe të sistemit për veprim në kushte të krizave dhe katastrofave.

Është obligim i shtetit që t'i vendosë dhe zhvillojë sistemet dhe standardet për parandalimin dhe uljen e pasojave nga katastrofat, duke shfrytëzuar kapacitetet shkencore dhe profesionale, veçanërisht detyrimet që burojnë nga një sërë rezolutash të OKB, kornizash ndërkombëtare, direktivash të BE në lidhje me mbrojtjen civile, standardesh të NATO dhe përvojash krahasuese nga shtetet tjera si dhe organizatave dhe asociacioneve ndërkombëtare.

Mekanizmi kombëtar për koordinim dhe udhëzime në pjesën e uljes së rreziqeve nga fatkeqësitë dhe katastrofat, për nga vetë natyra është multisektorial dhe ndërdisiplinor dhe i përfshin të gjitha subjektet kompetente dhe të interesuara në shoqëri. Menaxhimi me rreziqet ndërkaq, përfshin identifikimin e tyre, përcaktimin se sa ka gjasë që ato të paraqiten, vlerësimin e ndikimeve potenciale dhe masat për uljen e rreziqeve që përfshin lokalizimin e rrezikut, analizën e ndjeshmërisë, vlerësimin e humbjeve potenciale dhe parandalimin strategjik – zbutjen e pasojave nga katastrofa.

Kjo platformë është botimi i katërt i reviduar në të cilin edhe më tej janë aktuale shumë vlerësime, prioritetet dhe udhëzime nga botimet paraprake, por ajo që është kyçe, është fakti se, në të njëjtin, krahas detyrimeve të Hjugos dhe Forumit evropian, përfshihen edhe përcaktimet thelbësore të Kornizës për Ulje të Rreziqeve nga Katastrofat nga Sendai, të miratuar nga OKB në vitin 2005, të Marrëveshjes së Parist për ndryshimet klimatike dhe të dokumenteve të tjera.

[†] Platforma Nacionale për Uljen e Rreziqeve nga Katastrofat është e miratuar në Seancën e njëqind e pesëdhjetë e dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 3 shtator 2019.

Prioritet i jepet organizimit të sistemit për veprim në kushte të krizave, kapaciteteve institucionale, bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe përkufizimit dhe konkretizimit të detyrimeve prioritare të institucioneve shtetërore, mobilizimit të publikut, sektorit joqeveritar, opinionit të ekspertëve dhe atij profesional në ndërtimin e sistemit për mbrojtje dhe rritje të operacionalizimit, efikasitetit dhe efektivitetit.

2. Bazat e Platformës nacionale për Ulje të Rreziqeve nga Katastrofat

Platforma nacionale për Ulje të Rreziqeve nga Katastrofat është përmbledhje prioritetesh, të pritshmërive dhe detyrimeve që janë në funksion të ndërtimit të sistemit efektiv dhe efikas për mbrojtje dhe shpëtim.

Platforma nacionale për ulje të rreziqeve nga katastrofat bazohet në detyrime që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Koncepti kombëtar për siguri dhe mbrojtje, Strategjia Nacionale për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ligji për Menaxhim me Kriza, Ligji për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ligji i Policisë, Ligji për Mbrojtje, Metodologjia për përmbajtjen dhe mënyrën e vlerësimit të rreziqeve dhe planifikimit të mbrojtjes dhe shpëtimit dhe nga analiza të tjera, vlerësime, punime shkencore etj.

Në ligje janë të definuara edhe detyrime konkrete të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve publike, kompanive, qytetarëve dhe subjekteve të tjera të sistemit për kriza, veçanërisht të Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qendrës për menaxhim me kriza, Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë për Mbrojtje, Ministrisë për Shëndetësi, Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe subjekteve të tjera të sistemit për kriza.

Prioritetet dalin edhe nga strategjitë ndërkombëtare dhe kornizave të miratuara nga OKB siç janë: Korniza për Veprim nga Hjogo dhe Korniza për Veprim nga Sendai.

Në Platformë, në mënyrë të veçantë pasqyrohen detyrimet që burojnë nga Korniza për Veprim nga Sendai në të cilën janë përkufizuar prioritetet kyçe.

2.1 Korniza për Veprim nga Sendai për periudhën e viteve 2015 – 2030

Prioriteti 1: Kuptimi i rrezikut nga katastrofat

Menaxhimi me rreziqet nga katastrofat duhet të bazohet në të kuptuarit e rrezikut nga katastrofat në të gjitha dimensionet e saj të ndjeshmërisë, kapacitetit, ekspozimit të personave dhe mjeteve, karakteristikave të rrezikut dhe të mjedisit jetësor. Njohuritë e këtyre mund të përdoren për vlerësimin e rrezikut, parandalimin, zbutjen, përgatitjen dhe reagimin.

Prioriteti 2: Përforsimi i menaxhimit me rrezikun nga katastrofat

Menaxhimi me rreziqet nga katastrofat në shkallë kombëtare, rajonale dhe globale është shumë i rëndësishëm për parandalimin, zbutjen, gatishmërinë, reagimin, rikuperimin dhe rehabilitimin. Kjo nxit bashkëpunimin dhe partneritetin.

Prioriteti 3: Investimi në uljen e rrezikut nga katastrofat dhe zhvillimi i rezistencës

Investimet publike dhe private në parandalimin dhe uljen e rreziqeve nga katastrofat përmes masave strukturore dhe jostrukturore janë të një rëndësie thelbësore për përmirësimin e qëndrueshmërisë ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të personave, bashkësive, vendeve dhe mjeteve të tyre, si dhe të mjedisit jetësor.

Prioriteti 4: Përmirësimi i gatishmërisë për katastrofat dhe përgjigjja efektive në rikuperimin, rehabilitimin dhe rekonstrukcionin.

Rritja e rrezikut nga katastrofat do të thotë se ekziston nevoja që të përforsohet gatishmëria për reagim gjatë katastrofave, të ndërmerret aksion në prag të ngjarjeve dhe të sigurohen kapacitete për reagim efektiv dhe rikuperim në të gjitha nivelet. Faza e rikuperimit, rehabilitimit dhe rekonstrukcionit është kritike që gjërat të shkojnë në drejtimin e duhur, përmes integritetit të masave për uljen e rreziqeve nga katastrofat në rrjete zhvillimore.

2.2 Forumi Evropian

Forum i Evropian për Uljen e Rreziqeve nga Katastrofat është forum rajonal për shkëmbimin e njohurive, ekspertizave, përvojave dhe informacioneve, me qëllim që të sigurohet qasje e koordinuar ndaj rreziqeve të natyrave të ndryshme, ku definohen procedura të standardizuara dhe mekanizma dhe të njëjtat janë të detyrueshme për autoritetet kombëtare.

Forum i evropian ka për qëllim të sigurojë aktivitete të vazhdueshme për uljen e rrezikut nga katastrofat dhe të parandalojë paraqitjen e rreziqeve të reja, t'u japë mbështetje pikave kombëtare për kontakt dhe të nxisë koordinim kombëtar, koherencë dhe ndjekje të përforsuar të progresit, ta rritë vetëdijen për uljen e rreziqeve nga katastrofat si pjesë përbërëse e zhvillimit të qëndrueshëm, të sigurojë riaftësimin ndaj ndryshimeve klimatike përmes avancimit të mjedisit jetësor, pakësimit të ndotjes së qyteteve etj., të nxisë investime për parandalimin e rreziqeve, të përforsojë përkushtimin e të gjithë aktorëve nga sektori publik dhe ai privat, të zhvillojë mekanizma për informim të qytetarëve se në ç'mënyrë të veprojnë gjatë kërcënimeve të caktuara etj. Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e këtij forumi nga vitit 2009 dhe në të njëjtin janë përfshirë 46 vende evropiane.

2.3 NATO

Me ratifikimin e protokollit për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Aleancën veriatlantike, vendi ynë fiton qasje edhe në Qendrën Koordinuese Veriatlantike për Reagim gjatë Katastrofave (EADRCC), i cili është mekanizmi kryesor civil për reagim në NATO në fushën euroatlantike. Ai është aktiv gjatë tërë vitit, operativ 24/7.

Qendra funksionon si sistem për koordinim të kërkesave për ndihmë nga vendet anëtare dhe për reagim nga strukturat e NATO-s për ndihmë, kryesisht në raste katastrofash natyrore dhe artificiale.

2.4 BE

Komisioni Evropian ka rol kyç në promovimin e uljes së rrezikut dhe aksioneve parandaluese. Në vitin 2016, Komisioni Evropian u pajtua me Planin Veprues për Zbatimin e Kornizës për Veprim nga Sendai, duke mbështetur qasjen për informim për rreziqet nga katastrofa në të gjitha politikat e BE-së. BE fokusohet në ndjeshmërinë, e jo vetëm në rreziqet. BE synon të ketë qasje më të gjerë për zbutjen e rrezikut.

Gjatë viteve të kaluara, menaxhimi me rreziqet është integruar në mënyrë sistematike në programet dhe projektet e BE-së për ndihmë humanitare në të gjitha sektorët. Në vitin 2017, 65 % nga të gjitha projektet humanitare, të financuara nga BE, përfshinin komponentë për gatishmërinë gjatë katastrofave.

BE ndan një pjesë nga buxheti i saj humanitar vjetor (50 milionë euro në vitin 2018) për projekte qëllimore që kanë të bëjnë me gatishmërinë për katastrofa, duke u përqendruar në prioritetin 4 nga Sendai (përmirësim i gatishmërisë për katastrofa dhe reagim efektiv me zbatim të qasjeve me më shumë rreziqe). Ky financim e përforcon aftësinë e sistemeve kombëtare dhe lokale për gatishmëri që të përgjigjen më herët dhe në mënyrë më efikase.

BE investon edhe në sisteme për paralajmërim të hershëm, në ndjekje dhe ndërtim të kapaciteteve kombëtare dhe lokale për reagim. BE i mbështet partnerët në zhvillimin e metodave efektive për zbutjen e rreziqeve dhe mbledhjen e dëshmive me qëllim që të arsyetohet gatishmëria e veprim të hershëm.

Çdo strategji për gatishmëri për katastrofa dhe shpërndarje të mjeteve, përfshin edhe strategji dalëse të definuar, ku kapacitetet lokale konsiderohen si të përshtatshme ose ku autoritetet lokale ose partnerët zhvillimorë, të njëjtët mund t'i ndërmarrin.

Krahas kësaj, BE i angazhon dhe i mbështet strukturat qeveritare lokale dhe kombëtare në të gjitha vendet e botës përmes mekanizmit për mbrojtje civile të BE-së, veçanërisht në fushat për parandalim dhe gatishmëri.

Nisma e BE-së për ndihmë vullnetare, e cila qytetarëve të Evropës u ofron mundësi për t'u kyçur në projekte për ndihmë humanitare, ka për qëllim përforcimin e kapacitetit dhe qëndrueshmërinë e bashkësive të rrezikuara në vendet që nuk janë anëtare të BE-së, përmes zbatimit të aksioneve të përbashkëta ndërmjet operatorëve humanitarë me përvojë dhe organizatave lokale.

Katastrofat që kanë të bëjnë me kushtet e motit mund të jenë të ndërlikura me efektet nga ndryshimet klimatike, trend ky që në të ardhmen do të rritet akoma më shumë, me çka zbutja e rreziqeve nga katastrofat do të jetë faktor kyç për implementim të suksesshëm të strategjive zhvillimore.

Në qershor të vitit 2013, nga ana e institucioneve të Bashkimi Evropian (Parlamentit Evropian me propozim të Komisionit Evropian) u miratua Plani Veprues për vendet që kanë vështirësi gjatë ballafaqimit me kriza në periudhën ndërmjet viteve 2013-2020, në të cilin janë dhënë propozime për përparim në zbatimin e parimeve dhe të prioritetëve të cekura në komunikimin dhe përfundimet e Këshillit.

Ai i vendos themelet për bashkëpunim më efikas në BE për ndërtimin e qëndrueshmërisë, me çka bashkohen aktivitetet humanitare, bashkëpunimi afatgjatë zhvillimor dhe angazhimi politik rrjedhës.

2.4.1 Vlerësime dhe rekomandime të Komisionit Evropian

Në periudhën 15 - 25 tetor të vitit 2018, në Republikën e Maqedonisë së Veriut u realizua Programi "Peerreview" (evaluim formal nga ana e ekspertëve nga vende të tjera që punojnë në problematikën e njëjtë, të cilët e analizojnë sistemin për menaxhim me rreziqe nga katastrofa) në suaza të bashkëpunimit me BE-në për mbrojtje civile dhe menaxhim me rreziqe nga katastrofa.

Qëllimi këtij procesi është të sigurohet shkëmbimi i praktikave pozitive, të forcohet mësimi dhe mirëkuptimi i përbashkët dhe të arrihen rekomandime të besueshme dhe profesionale.

Ekipi për evaluim dorëzoi raport, në të cilin janë identifikuar praktikat e mira, por edhe fushat në të cilat nevojitet përmirësim dhe për të cilat propozoi një sërë rekomandimesh. Meqë problemet dhe sfidat e identifikuar gjatë evaluimit janë sistemore dhe strukturore nga vetë natyra, në raport u formulua strategjia për ballafaqim me faktorët nga të cilët këta dalin dhe u ofruan disa rekomandime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Në të, theksohet se këta rekomandime, nëse operacionalizohen nga ana e kreatorëve të politikave, mund ta përmirësojnë sigurinë e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut.

Të gjitha subjektet e sistemit për kriza kanë obligim për implementimin e rekomandimeve nga “Peerreview” të përgatitur nga BE, ku në thelb propozohen reforma në sistemin për kriza, mbrojtje dhe shpëtim, sigurim të një uniteti funksional, efikasitet dhe efektivitet të sistemit në menaxhimin, mbrojtjen dhe shpëtimin në kushte të krizës.

3. Qëllimet e Platformës Nacionale për Uljen e Rreziqeve nga Katastrofat

Qëllimet themelore të Platformës janë parandalimi, para së gjithash përmes uljes së rreziqeve nga katastrofat, paralajmërimi i hershëm, të vepruarit në kushte të katastrofës, reduktim të pasojave nga katastrofat dhe të vepruarit pas katastrofave.

3.1 Parandalimi

Shteti mund të kontribuojë në pakësimin e materialeve të dëmshme dhe viktimave njerëzore nga katastrofat, vetëm nëse aktivitetet që i ndërmarrin institucionet shtetërore dhe lokale, orientohen drejt një menaxhimi të suksesshëm të rreziqeve nga katastrofat para se ato të paraqiten, në vend që katastrofat të menaxhohen pas paraqitjes së tyre. Për këtë qëllim, theksi duhet të vihet në parandalimin e rreziqeve të reja dhe në uljen e atyre ekzistuese si dhe përgjegjësia primare e të gjitha institucioneve të jetë në këtë drejtim, në parandalimin e katastrofave natyrore dhe katastrofave të shkaktuara nga faktori njeri.

Parandalimi bazohet në dy shtylla: identifikimin e rrezikut (identifikimin e rreziqeve të vërteta me të cilat ballafaqohet bashkësia) dhe vlerësimi i rrezikshmërisë (vlerësimi i rrezikut dhe i kapacitetit i bashkësisë për t’u ballafaquar me pasojat nga katastrofa).

Në përputhje me sfidat dhe ngjarjet bashkëkohore, vëmendje më e lartë i kushtohet parandalimit të rreziqeve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, urbanizimit të paplanifikuar dhe të shpejtë, keqmenaxhimit me tokën, ndryshimet demografike, angazhimit të dobët institucional, informimit të pamjaftueshëm të qytetarëve, qasjes së kufizuar ndaj teknologjisë, shfrytëzimit të paqëndrueshëm të resurseve natyrore etj.

Që parandalimi të jetë efikas dhe efektiv, duhet t’i përfshijë llojet e ndryshme të rreziqeve dhe të jetë gjithëpërfshirës dhe i qasshëm për të gjithë qytetarët. Qeveria që e ka rolin kyç, drejtues dhe koordinues në proces, duhet t’i përfshijë të gjitha palët e interesuara: gratë, fëmijët, personat me nevoja të veçanta, personat nga shtresat më të ulëta të shoqërisë dhe qytetarët më të moshuar në krijimin dhe implementimin e politikave, strategjive dhe planeve vepruese. Këtu duhet të kyçet edhe sektori publik dhe privat, organizatat qytetare, akademike, institucionet shkencore dhe kërkimore dhe sektori afarist, që parandalimin e katastrofës ta integrojë në menaxhim të tyrin.

1. Për parandalim më të mirë, vlerësim të rreziqeve dhe gatishmërisë për reagim efektiv ndaj katastrofave, e një rëndësie të veçantë është të kuptuarit e rreziqeve nga katastrofat me të gjitha dimensionet dhe karakteristikat, rrezikshmëria dhe ekspozimi i njerëzve dhe i pasurisë.

Që rreziqet nga katastrofat të kuptohen në mënyrë më të përpiktë, nevojitet (në shkallë kombëtare dhe lokale) të bëhet mbledhja, analiza dhe shfrytëzimi i të dhënave relevante dhe i informatave praktike dhe ndarja e duhur e tyre, dërgimi dhe shpërndarja e kategorive të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve, si dhe qasja në këto informacione në kohë reale; të bëhen vlerësime periodike të rreziqeve, rrezikshmërisë dhe ekspozimit ndaj rrezikut dhe të përpunohen harta të rreziqeve me përdorimin e inovacioneve teknologjike bashkëkohore dhe komunikuese, të publikohen dhe jepen shpjegime për humbjet njerëzore dhe materiale nga katastrofat, përmes ndarjes së përvojave dhe leksioneve të mësuara, të trajnohen dhe edukohen përfaqësues qeveritarë nga vetëqeverisja lokale, sektori civil dhe privat për atë se çfarë aktivitete do të ndërmarrin, të përmirësohet bashkëpunimi dhe dialogu ndërmjet bashkësive shkencore dhe teknologjike dhe institucioneve tjera relevante, me qëllim që të sigurohet edhe qasje shkencore në krijimin e politikave.

Rekomandohet që informacionet për rreziqet nga katastrofat, parandalimin dhe zbutjen, përgatitjen, reagimin dhe rehabilitimin, të futen në të gjitha format e arsimit formal dhe joformal si edhe në arsimin profesional dhe trajnim.

Si prioritet kyç në periudhën e ardhshme është shqyrtimi i të gjitha vlerësimeve për rrezikshmërinë në nivel shtetëror dhe lokal nga katastrofat, obligim ky që është definuar në disa ligje.

2. Nevojitet vizion i qartë, plan, udhëzim, koordinim dhe përfshirje aktive të të gjithë palëve të interesuara për një menaxhim efikas dhe efektiv të katastrofave. Për këtë qëllim, secili shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara duhet të zhvillojë dhe zbatojë një strategji dhe plan veprimi për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat, me afate specifike kohore, qëllime dhe objektiva që synojnë parandalimin e krijimit të rreziqeve, zvogëlimin e rreziqeve ekzistuese dhe rritjen e rezistencës së shoqërisë.

Republika e Maqedonisë së Veriut në çdo tre muaj do të miratojë një plan veprimi me aktivitete konkrete, bartës të veprimtarive dhe afate specifike për zbatimin e detyrimeve.

3. Shteti duhet të stimulojë investimet në sektorin publik dhe privat, si masë parandaluese kundër fatkeqësitë e mundshme, të cilat do të kontribuojnë në shpëtimin e jetës njerëzore dhe mbrojtjen e të mirave materiale, dhe duhet të kontribuojnë në forcimin e rezistencës ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të qytetarëve dhe shoqërisë. në përgjithësi, si dhe të mjedisit jetësor.

Në këtë drejtim, sektori publik dhe ai privat duhet të inkurajohen të investojnë në infrastrukturën kritike dhe objekte siç janë shkollat, spitalet, kopshtet, objektet sportive, etj., Duke iu përmbajtur standardeve më të larta ndërkombëtare të ndërtimit dhe materialeve të ndërtimit dhe duke shfrytëzuar parimet universale të projektimit dhe performancës. Për atë që është ndërtuar tashmë nevojitet rinovim të rregullt, rindërtim dhe mirëmbajtje dhe të krijohet një kulturë e kujdesit për infrastrukturën në përgjithësi, duke kontrolluar rezistencën e digave, urave dhe lehtësirave të tjera.

Krahas politikave dhe strategjive shtetërore, Republika e Maqedonisë së Veriut, si anëtare e Kombeve të Bashkuara ka përgjegjësi të ndalojë, parandalojë dhe zvogëlojë rreziqet e katastrofave përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, rajonal, ndërkufitar dhe dypalësh.

Ulja e rrezikut është një përgjegjësi dhe shqetësim i përbashkët për të gjitha shtetet anëtare të KB - së dhe për këtë arsye është e domosdoshme që ata të bashkëpunojnë, nga ku dalin edhe detyrimet dhe rekomandimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3.2 Paralajmërimi i hershëm

Përmes ndërtimit të një sistemi të zhvilluar dhe funksional për paralajmërim të hershëm, mundësitë për reduktim të pasojave nga katastrofat janë të mëdha.

Në këtë drejtim, përmes paralajmërimit të hershëm, është e mundshme të parandalohen dhe pakësohen rreziqet dhe pasojat nga katastrofat gjatë përmytjeve, zjarreve, erërave, prurjeve të borës, temperaturave të larta, ndotjes së ajrit etj. gjë që është kyçe në shmangien e viktimave njerëzore dhe në pakësimin e dëmeve ekonomike.

Përmes sistemit të integruar për menaxhim me ujërat, zbulimit në kohë të zjarreve, detektimit të ndotësve të ajrit, rregullimin e shtretërve të lumenjve, pastrimit të rrjetit kanalizues etj. në masë të madhe mund të reduktohen pasojat nga fatkeqësitë e tilla elementare apo të ngjashme.

Me zbatimin e sistemit "112" në masë të madhe do të sigurohet informim në kohë për qytetarët dhe institucionet kompetente në lidhje me katastrofat e mundshme dhe aktivizimin e sistemit të krizave. Informimi i shpejtë dhe mobilizimi i subjekteve të sistemit të krizave janë thelbësore për veprim efektiv dhe efikas, parandalimin dhe zbutjen e pasojave nga katastrofat.

Instalimi i sistemeve për parashikimin e tërmetejeve, vlerësimi i sasive të mundshme të reshjeve, instalimi i sistemeve të alarmimit nga zjarret, monitorimi i ndotjes së ajrit, alarmimi i emergjencave të mundshme në ndërtesat industriale, etj., Kërkon zhvillim dhe përdorim të sistemeve të sofistikuara të paralajmërimit të cilat janë thelbësore për paralajmërimin e hershëm të fatkeqësive të mundshme.

Në këtë drejtim, përmes zgjidhjeve ligjore, të gjitha subjektet duhet të kenë një detyrim ligjor, të krijojnë sisteme për zbulimin e fatkeqësive të mundshme dhe një mënyrë për të informuar institucionet shtetërore dhe qytetarët.

Sipas praktikave dhe standardeve të përcaktuara, në raste të katastrofave, është e nevojshme të ndërtohet një sistem udhëzimi se si veprojnë qytetarët dhe subjektet e tjera, me anë të të cilave duhet të përpunohen procedurat për të zvogëluar pasojat. Ky proces (edukativ dhe trajnues) duhet të jetë i vazhdueshëm.

Për të informuar qytetarët për katastrofat (krizat) e mundshme ose që janë ndodhur, është e nevojshme të implementohen edhe projekte tjera, siç janë informimi përmes mesazheve telefonike etj. zgjidhje që tashmë zbatohen në disa vende të BE-së.

3.3 Përgjigjja gjatë krizave

Përgjigjja gjatë krizave, marrja e masave dhe aktiviteteve të duhura në prag të, gjatë dhe menjëherë pas krizave (katastrofave) duhet të sigurojë që efektet e saj janë minimizuar dhe se personat e prekur nga rasti kanë marrë ndihmë dhe mbështetje.

Qëllimet prioritare janë:

- " sigurimi i informacioneve për publikun;
- " mbrojtja e jetës njerëzore;
- " kufizimi i përshkallëzimit ose zgjerimit dhe zbutjen e ndikimeve nga katastrofat;
- " mbrojtja e shëndetit të popullatës;
- " mbrojtja e mjedisit jetësor;
- " mbrojtja e pronës;
- " mirëmbajtja e shërbimeve normale në një nivel të duhur (siguria, furnizimi me ujë, ushqimi, ilaçi, etj.);
- " promovimi dhe lehtësimi i vetëndihmës në zonat e rrezikuara;
- " lehtësimi dhe rimëkëmbja e popullatës (përfshirë ndihmën humanitare, ndikimet ekonomike, infrastrukture dhe mjedisore).

Është e nevojshme që të gjitha subjektet t'i ndërmarrin përsipër detyrimet ligjore dhe të përgatisin plane për veprim në kohë katastrofe, respektivisht krizë me pasoja të mundshme. Planet duhet të azhurnohen dhe plotësohen vazhdimisht.

3.4 Sanimi i pasojave nga krizat

Nevoja për rikuperim është një përparësi kryesore pas katastrofave dhe krizave, respektivisht katastrofave natyrore dhe jonatyrore si tërmetet, përmbytjet, zjarret, etj. Rimëkëmbja është një proces kompleks dhe i gjatë, me çka qasja ndryshon në raste të tilla dhe në varësi të llojit dhe shkallës së rrezikshmërisë dhe pasojave nga kriza.

Elementi i rimëkëmbjes si pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të fatkeqësive - parandalimit, gatishmëria, reagimi dhe rimëkëmbja mund të jetë më i ndërlikuari dhe më i gjatë, pasi mes tjerash, varet nga materialet dhe burimet e tjera (kadrovike etj.).

Rezultatet më të mira arrihen duke siguruar strategji të rimëkëmbjes dhe duke i përafruar mundësitë me nevojat.

Nevojitet qasje e përbashkët, e koordinuar dhe e adaptueshme, ku përgjegjësia për katastrofa dhe sanime të pasojave është ndarë midis të gjithë sektorëve të shtetit, duke përfshirë edhe individët, familjet dhe grupet e komuniteteve, bizneseve dhe ngjashëm.

Qasja nën udhëheqjen e institucioneve shtetërore e mbështet kthimin e shpejtë të shërbimeve me kuptim thelbësor për nevojat njerëzore dhe paraqet mundësi për ndërtimin dhe përmirësimin e rrethanave në zonat e prekura dhe më gjerë.

Në planifikimin e sanimit të pasojave nga katastrofat, rol kryesor kanë njësitë e vetëqeverisjes lokale, kompanitë, sektori joqeveritar, por rol kryesor kanë edhe institucionet shtetërore, të cilat disponojnë me kuadër profesional, burime financiare dhe lloje tjera të burimeve.

4. Rreziqe – pasojat e mundshme nga fatkeqësitë, viktimat njerëzore, shkatërrimi i pronave

Katastrofat më së shpeshti shkaktohen nga kombinimi i rrezikshmërive të ndërvarrura nga natyra/teknike-teknologjike siç janë erërat e forta, reshjet ekstreme, temperaturat ekstreme të ajrit, ngrirja, mjegulla dhe thatësia – që mund të përforcohen më shumë me ndryshimet klimatike aktuale. Ngjarjet e tilla të mëdha mund të rrezikojnë jetën e njerëzve, në mënyrë negative ndikojnë në mjedisin jetësor dhe shkaktojnë rrezik për mbijetesë të shumë llojeve bimore dhe shtazore. Tërmetet e kombinuara me rreziqe gjeologjike (ndoshta edhe biologjike apo teknike-teknologjike) mund të ketë pasoja të mëdha dhe afatgjate për gjithë shoqërinë – viktimat e mundshme njerëzore dhe dëme të mëdha të botës bimore dhe shtazore dhe trashëgimisë kulturore.

4.1 Ndryshimet klimatike dhe Marrëveshja e Parisit për Ndryshimet Klimatike

Ndryshimet klimatike janë problem global. Sipas disa analizave, ulja e përgjithshme e emetimeve që mund të arrihet është 20 për qind sa i përket asaj kur nuk ndërmerren masa reduktuese. Në sektorin e energjisë kjo do të realizohet me ndryshimin e karburanteve – qymyrit dhe naftës me gaz, burimet e rinovueshme të energjisë – hidroenergjisë, energjisë solare, të erës, gjeotermale dhe biomasës.

Ekzistojnë shumë prova dhe shkallë e lartë në pajtim me qarqet shkencore se ndryshimet klimatike është për shkak të rritjes së emetimeve të gazrave të qelqta nga aktivitetet që kryejnë njerëzit, në rend të parë emetimet e dioksid karbonit gjatë djegies të karburanteve fosile. Emetimet e këtyre gazrave për tre dekadat e fundit janë rritur për 70 për qind, me tendencë për rritje të vazhdueshme nëse në të ardhmen mbahen praktikatat dhe sjelljet rrjedhëse. Sipas Skenarit të Emetimeve (SSE) parashikohet rritje madje për 90 për qind të emetimeve të gazrave të qelqta në vitin 2030 në krahasim të vlerave të vitit 2000.

Prandaj, janë të nevojshme ndryshime në stilin dhe shprehjet njerëzore. Ndryshimet klimatike do të ndodhin. Në pyetje është se a do të investojmë më shumë në zbutjen e tyre dhe aftësimin apo në parandalimin e pasojave. Për shembull, koncentratet të mbahen në nivel që do të kufizonin rritjen e temperaturës globale për 2,8–3,2 shkallë celsius në vitin 2030, është e nevojshme të investohet 0,2-2,5 për qind nga prodhimi bruto global kombëtar. Si rezultat i ndryshimeve klimatike supozohet “zhvendosje e Saharës drejt Mesdheut”, andaj në atë kuptim edhe Dalmacia do të dukej në shkretëtirë.

Ndryshimet e projektuara të temperaturës dhe reshjet në shtetin tonë deri në vitin 2100 tregojnë se temperatura mesatare mund të rritet deri në 3,80 shkallë celsius, ndërsa reshjet mund të ulen për 13 për qind në krahasim me periudhën e vitit 1961-1990. Rajone të veçanta do të pësonin më shumë, si pjesa juglindore dhe qendrore, ku ndryshimet mund të jenë më dramatike. Ky lloj i ndryshimeve klimatike do të pasqyroheshin negativisht ndaj të gjithë sektorëve të ekonomisë, bujqësisë, pylltarisë, burimet ujore, biodiversitetin dhe ndaj shëndetit të njerëzve.

Më 12 dhjetor të vitit 2015 në Paris, palët e UNFCCC (The United Nations Framework Convention on Climate Change - Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike) arritën marrëveshje të rëndësishme për luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe për përsheptimin dhe intensifikimin e aktiviteteve dhe investimeve të nevojshme për një të ardhme të qëndrueshme të karbonit. Marrëveshja e Parisit e ndërton Konventën dhe për herë të parë i bëri të gjitha kombet me qëllim të përbashkët për të ndërmarrë hapa ambicioze për luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe t'u përshtaten efekteve të tyre, me mbështetje më të madhe që t'u ndihmohet ta bëjnë atë vendet në zhvillim.

Qëllimi i Marrëveshjes së Parisit është që ta përforcojë përgjigjen globale e kërcënimit nga ndryshimet klimatike përmes mbajtjes së temperaturës globale në këtë shekull nën 2 gradë celsius mbi nivelin dhe të vazhdojë me përpjekjet për kufizimin e rritjes së temperaturës madje deri në 1,5 gradë celsius. Marrëveshja, plotësisht ka për qëllim ta rrisë vetëdijen e vendeve që të merren me ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe t'i bëjnë rrjedhat financiare në përputhje me emetimet e ulëta të gazrave të qelqta.

Që të arrihen këto qëllime ambicioze, mobilizim përkatës dhe sigurimi i burimeve financiare, duhet të vendos kornizë të re teknologjike dhe ndërtim të fuqishëm të kapaciteteve, me çka do të mbështeten aktivitetet nga vendet në zhvillim dhe vendet e rrezikuara, në përputhje me qëllimet e tyre. Marrëveshja, gjithashtu, parasheh kornizën e zmadhuar të transparencës për aksion dhe mbështetje.

Marrëveshja e Parisit kërkon që të gjitha palët të bëjnë përpjekje përmes "kontributeve të përcaktuara në shkallë kombëtare" (QDN) dhe të rritin këto përpjekje në vitet e ardhshme. Kjo përfshin të gjitha kërkesat e palëve të raportojnë rregullisht mbi emetimet e tyre dhe përpjekjet e tyre të zbatimit. Do të ketë gjithashtu një përqindje globale çdo 5 vjet për të vlerësuar përparimin kolektiv drejt arritjes së qëllimit të marrëveshjes dhe për të informuar palët për aktivitetet e mëtejshme individuale nga ana e palëve.

Marrëveshja e Parisit u hap për nënshkrim me 22 prill të vitit 2016 – Dita e Planetit Tokë – në selinë e KB-së në Nju Jork. Ajo hyri në fuqi me 4 nëntor 2016, 30 ditë pas të ashtuquajturës "Pragu i dyfishtë" (ratifikimi nga 55 vende të cilat marrin pjesë me më së paku 55% të emetimeve globale). Që atëherë, më shumë vende e ratifikuan dhe vazhdojnë ta ratifikojnë Marrëveshjen, duke arritur gjithsej 125 nënshkrues në fillim të vitit 2017.

Me qëllim Marrëveshja e Parisit të jetë plotësisht operative, ishte hapur program punues në Paris për t'u zhvilluar modalitete, procedura dhe udhëzime për spektër të gjerë çështjesh. Që nga viti 2016, palët punojnë së bashku në filialet (APA, SBSTA dhe SBI) dhe organe të ndryshme të përbërëse.

Përfundimi është se jetojmë në një botë ku klima ndryshon, që paraqet njërin prej sfidave më të mëdha me të cilat ballafaqohemi. Ndryshimet e klimës janë proces natyror dhe ndodhë prej formimit të planetit tonë, por tani njerëzit janë ata që ndikojnë mbi klimën dhe shkaktojnë ndryshime me pasoja të paparashikueshme. Gjithnjë e më shpesh dhe më shumë do të ndodhin ngjarje ekstreme të motit, që do të jenë dukuri e zakonshme.

Pa marrë parasysh se a janë shkaktuar nga aktivitetet e njerëzve ose janë pjesë e ciklit natyror të planetit Tokë, ekspertët pajtohen në dy punë: kur dihet se Toka bëhet planet urban dhe më shumë se 60% e popujve të botës sot jetojnë në qytete, pritet numri më i madh i njerëzve të përjetojnë pasoja më të rënda në mjediset urbane.

Ndryshimi i klimës është problem global, por pasojat do të ndjehen atje ku janë edhe arsyet për atë, në nivel rajonal dhe lokal dhe atje këto probleme do të jenë arsye për kujdes më të madh dhe aksion të planifikuar. Qytetet janë të rrezikuara për shkak përqendrimit të madh të popullit dhe objektet e ndërtuara në hapësira të vogla. Por qytetet janë edhe shumë të varura nga infrastruktura: sistemi transportues, sistemet komunikuese, shpërndarja e ujit dhe energjisë si dhe sistemet e ujërave të zeza. Përqendrimi i njerëzve dhe të mirave në qytete dhe varësia e tyre nga këto sisteme infrastrukturore i bëjnë qytetet më të rrezikuara nga ndryshimet klimatike.

Republika e Maqedonisë së Veriut patjetër duhet t'i respektojë detyrimet e Marrëveshjes së Parisit, për shkak se ajo është në interes të qytetarëve dhe faktor kyç për mjedis më të shëndetshëm jetësor.

4.2 Ekosisteme

Ekosistem paraqet tërësi dhe bashkësi e organizmave të gjalla (bimë, kafshë, mikroorganizma, njeri) dhe natyrën jo të gjallë (toka, dielli, dheu, atmosfera, kushte klimatike, klima) në mjedisin jetësor ose në hapësirat e caktuara afariste, në të cilat ato janë të lidhur pandarje. Ekosistemi është sistem pafund i komplikuar dhe dinamik i pjesëve të lidhura të cilat veprojnë njëra me tjetrën, drejtpërdrejtë ose indirekt, andaj është në ndryshim të vazhdueshëm.

Ekosistemet ndahen në tokësore(malore, barishtore, pyjore) dhe ujore (detare, liqenore, lumore).

